



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1299/4 Prot.

Patos, më 20.05 / 2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 19 MAJ 2026

Vendi: Njësia administrative Zharrëz, Salla e mbledhjeve

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjuesë publike me temë: “Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027.”

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”.

Pjesëmarrës: Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtore e Financave znj. Mimoza Shtëmbari, Anëtarë GMS, përfaqësues të bashkisë Patos, me pjesëmarrjen e **23 pjesëmarrësve** (banorë, kryetarë të fshatrave, fermerë etj)

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba

Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba- Të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Sekretare e Këshillit
Znj. Refaela Xeba**

**Dëgjuesë publike
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027.”**

Maj 2026

pjesë të kësaj dëgjese publike. Tema e kësaj dëgjese është Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027. Kjo dëgjuesë është e bazuar në ligjin nr. 139/2015

“Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027”. Jemi në hapat e parë të procedurës për hartimin e PBA-së dhe presim kërkesat të tjera tuaja që mund të keni për PBA dhe buxhetin. Do ju lutesha që fjala të merrej me rradhë dhe të prezantoheshit gjatë kërkesave tuaja. Ju faleminderit!

Banor në Zharrës, z. Tajar Ajdini- Kam kërkesë për pastrimin e kanaleve në Sheqishte. Do digjemi se njëherë u dogja unë. Duhet pastruar kanalet patjetër. Edhe kanalizimet kryetar nuk i kemi do ishte mirë të bëheshin.



**Banor në Zharrës
z. Tajar Ajdini**

**Dëgjesë publike:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare
të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit
2027.”**

Maj 2026

Banor në Zharrëz, z. Flamur Grëmbi- Duhet të bëni një investim për dritat dhe energjinë elektike në fshatin Zharrëz. Bizneset që kanë sera nuk kanë energji elektrike. Gjithashtu kërkojmë dhe ndriçim. Shtruat rrugën te shkolla “Sotir Çapo” Zharrëz, ajo është shumë e ngushtë nuk kalon dot fare. Ajo rrugë duhet zgjeruar. Dokumentat e tokës i kam me probleme pasi kam tokë të trashëguar dhe gjykata ma ka kthyer me vendim gjykate. Si do ta zgjidh?



**Banor në Zharrëz
z. Flamur Grëmbi**

**Dëgjesë publike:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027.”**

Maj 2026

Banor i fshatit Zharrëz, z. Hamit Grëmbi- Kam një problem me rrugën e parcelave në Verbas nga Agim Çepele deri lart dhe duhet investuar ajo rrugë. Duhet të sistemohet rruga pasi nuk kalojmë dot që ta punojmë dhe të mbushet. Është rreth 700 m e gjatë si rrugë. Problem tjetër është pastrim i lagjeve pasi nuk janë pastruar. Varrezat nuk janë pastruar gjithashtu. Problem është dhe Albpetroli pasi janë dhe pusët e naftës, u bënë pastrimet e tyre dhe u mbuluan me dhera përsipër. Tani kanë shpëthyer nga temperaturat dhe do shpërthejë sera në toka. Albpetroli ka thënë do ndërhyrje dhe nuk ka ndërhyrë. Duhet të pastrohen toka nga nafta sepse toka ngelet pa prodhim kur bie nafta në të. Vera po vjen dhe do shpërthejë sera dhe nafta përsëri do na dëmtojë tokën. Gjithashtu kam dhe një shqetësim pasi u bë trotuari dhe u vendosën pemë për hije, por pemët janë prerë dhe janë dëmtuar te rruga kryesore në Zharrëz nga njerëzit.



**Banor i fshatit Zharrës
z. Hamit Grëmbi**

**Dëgjesë publike:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Novruz Toska- Përsëritet të gjithëve! Sezoni i vaditjes erdhi dhe në rezervuarin e Kurjanit është bërë një investim nga shteti dhe kërkojmë nga ju që



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Novruz Toska**

**Dëgjesë publike:
“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

ta mbushni me ujë për vaditje. Kjo i intereson të gjithë fermerëve dhe banorëve. Stolat për stacionin e autobuzit u vendosën dhe do vendosen dhe mbulesat lart që të mbrohem nga shiu. Kjo është një anë pozitive, por duhet të ndërgjegjësohen njerëzit sepse heqin dërrasat dhe

vidat. Zharrëza dhe Novosela ka kanalizime të ujërave të zeza. Në Verbas ka filluar projekti dhe është lënë gjysëm. Mendoj që në planet tuaja duhet të jetë edhe përfundimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në Verbas. Verbasi është i vetmi fshat që nuk ka trotuarë edhe pse rruga ka sipërfaqe të mjaftueshme për trotuarë.

Kryetar i fshatit Zharrëz, z. Abedin Hoxha- Përshendetje! Për sa i përket problemit që u për energjinë elektrike në fshatin Zharrëz, unë di që u bë një gabim te sektori 7 dhe u bë me qëllim për të lidhur fshatin Zharrëz nga nafta. Kjo zgjati për një kohë të shkurtër dhe nuk e di pse u shkëput përsëri. Gjatë kësaj kohe kam patur kontakte me OSHEE Fier dhe më thanë që do e lidhnin përsëri por nuk e kanë lidhur akoma. Lidhur me problemet e tjera të fshatit, kemi një kanal vaditës që fillon nga shtëpia e Durim Bani deri të grupi 490 i naftës dhe është në gjendje të keqe. Duhet një pastrim patjetër. Kemi dhe një problem me rrugën e Zabies që nuk ka përfunduar sepse do filloj sezoni i ullirit përsëri dhe nuk kemi ku të kalojmë. Kemi dhe problem me rrugët te arët e vogla.



**Kryetar i fshatit Zharrëz
z. Abedin Hoxha**

Dëgjësë publike:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Banor i Zharrëzës, z. Luftar Beluli– Përshëndetje! Në lagjen tonë rruga është shumë problematike. Në atë rrugë kalojnë shumë banorë dhe duhet ndërhyrë. Është rruga Belulaj ajo për të cilën po flas. Duhet dhe ndriçim.



**Banor i Zharrëzës
z. Luftar Beluli**

Dëgjesë publike:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Banor në Zharrëz, z. Redion Hoxha- Unë kam një banesë në zonën pas lumit. Punonjësit e gjelbërimit nuk kanë ardhur të bëjnë pastrimin e barit. Ndriçim nuk kemi në atë zonë anë e lumit. Rruga gjithashtu është carë disa herë nga ujësjellsit dhe është në gjendje shumë të keqe për shkak të çarjeve.



**Banor në Zharrëz
z. Redion Hoxha**

Dëgjesë publike:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Banor në Zharrëz, z. Fuat Bani- Ne jemi pensionistë dhe unë kam një kërkesë. Punonjësit duhet të fillojnë me radhë që nga pastrimi i varrezave, gjelbërimi i zonave etj. Për sa i përket dokumentave të pronave kemi kaq vite nuk po i bëjmë dot me dokument pronësie. Kemi gjithashtu problem me energjinë elektrike, linjat kanë rënë në tokë dhe janë problem. Unë ujë nuk kam, ndriçim nuk kam, kanalizim të ujërave të zeza nuk kam. Rrugët e parcelave në Zharrëz janë problem nuk kalon dot, po prishet prodhimi se nuk kalojmë dot.



**Banor në Zharrëz
z. Fuat Bani**

Dëgjesë publike:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Për pjesën e buxhetit, rruga e Belinës po bëhet, rruga e argjinaturës po në Belinë gjithashtu do bëhet. Janë dhe disa segmente rrugore që janë parashikuar për këtë vit. Rreth 90% e rrugëve në Zharrëz do bëhen me ndriçim këtë vit. Po bëhen dy ministacione të reja vaditje në Sheqishte. Gjithashtu janë parashikuar 5 rrugë me çakull në njësinë Zharrëz. Te pjesa e elektrikut nuk ndërhyjmë dot si institucion pasi e ka OSHEE detyrë funksionale.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Banor në Zharrëz, z. Fuat Bani- Unë kam disa probleme me Zharrëzën duke filluar me rrugën nga Dinallarët deri të varrezat, rruga nga Novosela është hapur e gjitha dhe nuk është bërë.

Kryetar i fshatit Belinë, z. Agim Grembi- Ne kemi disa probleme. Kemi dy rrugë pas lumit që i kemi sistemuar vjet, por duhet ti nivelojmë dhe sistemojmë përsëri. Na duhet dhe skrepi për të skarifikuar kanalin vaditës. Gjithashtu duhet dhe ndriçim pasi janë ndjegur shumë llamba. Më e rëndësishme është rruga nga lumi për tu sistemuar.



**Kryetar i fshatit Belinë
z. Agim Grembi**

Dëgjesë publike:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare të
PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit 2027”**

Maj 2026

Banor në Zharrëz, z. Rufan Beluli– është një kanal vaditës te toka ime që duhet pastruar me skrep. Unë paguaj taksat ndaj kërkoj dhe shërbim. Kanali është nga ura deri këtej te rruga Halit Gjeriti.

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj



Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

